




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.10/24

Datë: 01.02.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 01.02.2024, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET. Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me marrjen e kontrollit të vetëm nga NLB Skladi upravljanje premoženja d.o.o., (blerës). Generali Investments, družba za upravljanje, d.o.o (shitës) mbi kompaninë e menaxhimit të fondeve të investimeve Generali Investments AD Skopje (targeti).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 24.11.2023, me Nr. Prot. 566/23-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me marrjen e kontrollit të vetëm nga NLB Skladi d.o.o., (blerës). Generali Investments d.o.o., (shitës) mbi kompaninë e menaxhimit të fondeve të investimeve Generali Investments AD Skopje (targeti).

Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 04.01.2024
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 05.01.2024
3. Palët kanë lidhur Marrëveshja për Blerjen e Aksioneve, nënshkruar më 10 Nëntor 2023

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
4. Marrëveshjen lidhur mes lidhur palëve për Blerjen e Aksioneve, nënshkruar më 10 Nëntor 2023.
5. Kërkesa për përqendrim, është bërë për arsye se Aplikuesi ka filiale të regjistruar në Republikën e Kosovës.

NLB Skladi, upravljanje premoženja, d.o.o., një kompani e organizuar sipas ligjeve të Sllovenisë me numër të regjistrimit të biznesit 1876031000 dhe adresë të regjistruar në Tivolska cesta 48, 1000 Lublanë, Slloveni. Blerësi NLB Skladi, upravljanje premoženja, d.o.o. nuk ka kompani në Kosovë. Entiteti i vetëm në Grupin e kompanive të Blerësit, pra NLB Group, i cili është i themeluar dhe regjistruar në Kosovë është NLB Banka SH.A. NLB Banka SH.A. është në pronësi të drejtpërdrejtë të filialit të bankës Sllovene NLB d.d e cila mban 82,377% të kapitalit aksionar në NLB Banka SH.A.

General Investments, družba za upravljanje, d.o.o., një kompani e organizuar sipas ligjeve të Sllovenisë me numër të regjistrimit të biznesit 5834457000 dhe adresë të regjistruar në Dunajska cesta 63, 1000 Lublanë, Slloveni. General Investments, družba za upravljanje, d.o.o. nuk ka kompani në Kosovë ose ndonjë formë tjetër prezence në Kosovë.

General Investments AD Skopje, një shoqëri aksionare e themeluar dhe e licensuar sipas ligjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me seli në Blvd. Parizanski odredi nr. 14A-1/2, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, me numër unik të regjistrimit 6364578 targeti). General Investments AD Skopje nuk është prezent në asnjë formë në territorin e Republikës së Kosovës.

Tregu Relevant:

Tregu i produktit: Tregu i shërbimeve financiare që lidhen me menaxhimin e fondeve të investimeve.

Tregu gjeografik: në transaksionin e propozuar është territori i Republikës së Kosovës.

Pjesa tjetër e këtij parashtrimi fokusohet në tregun e ngushtë për menaxhimin e fondeve të investimeve në Kosovë.

Analiza e konkurrencës

Transaksioni i propozuar nuk ngritë ndonjë shqetësim për konkurrencën në tregun përkatës të Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh që, transaksioni nuk rezulton në asnjë mbivendosje horizontale ndërmjet palëve në tregun e ngushtë të shërbimeve menaxhuese të fondeve të investimeve. NLB Group nuk ka ushtruar asnjë aktivitet të menaxhimit të fondeve të investimit në Kosovë. Shtësi dhe Targeti si dhe kompanitë e tjera brenda Generali Group asnjëherë nuk kanë ushtruar asnjë aktivitet të menaxhimit të fondeve të investimit në Kosovë. Transaksioni nuk ngritë asnjë shqetësim për konkurrencë pavarësisht përcaktimit të saktë të tregut. Në Kosovë, tregu për fondet e investimeve private aktualisht nuk është i zhvilluar dhe rrjedhimisht, aktiviteti i bankave

dhe institucioneve të tjera financiare që operojnë në tregun e Kosovës, në lidhje me menaxhimin e tillë të fondeve të investimeve private është i dobët ose thujse inekzistent.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se Blerësi është kompani e ndërlidhur e NLB Group e cila është prezent në territorin e Republikës së Kosovës përmes filialit të tij NLB Banka SH.A. Gjithashtu, NLB Group është prezent në tregun e Kosovës edhe përmes degës së bankës serbe NLB Komercijalna Banka a.d. Beograd. Mirëpo duke pasur parasysh që tregu përkatës i produktit ka të bëjë me një treg pak të zhvilluar në Kosovë transaksioni nuk do të paraqes ndonjë shqetësim për konkurrencën në Kosovë pasi që, palët në përqendrim nuk kanë ndonjë plan të menjëhershëm për të realizuar kërkime apo investime në Kosovë në lidhje në tregun e menaxhimit të fondeve të investimeve.

Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk do të kenë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në tregun përkatës.

Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar se ky transaksion, nuk do të paraqesë efekte negative në konkurrencë, për arsye se ky transaksion /blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse tek operatorët ekonomik apo konsumatorët.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURENCËS


Neime Binaku-Isufi
Kryetare




Kaltrina Sela
Zv. Kryetare



Nafije Osdautaj
Anëtare



Florent Mehmeti
Anëtar



Salih Gashi-Loku
Anëtare



III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
-
- Arkiva